

BULETIN

Nr. 12 / Prill 2024



*“Një fillim i mbarë
për një të ardhme të sigurt”*

- ➔ Siguri
- ➔ Disiplinë
- ➔ Këshillim karriere
- ➔ Ushqim i kontrolluar
- ➔ Transport i garantuar
- ➔ Staf i kualifikuar me përvojë
- ➔ Aktivitete artistike dhe sportive
- ➔ Mundësi akomodimi në konvikt
- ➔ Metoda e kushte bashkëkohore
- ➔ Asistencë për studim jashtë vendit
- ➔ Shërbim psiko-social dhe mjekësor
- ➔ Mësimdhënie në gjuhën angleze, klasa VI-XII
- ➔ Përdorimi i paisjeve të avancuara teknologjike
- ➔ Gjuhë të huaja (anglisht, gjermanisht dhe turqisht)



Redaksia

Lumturie Gjura
Elsona Okshtuni
Suada Kroj
Elida Kadiu
Mynevere Terpo
Aurelda Qama

Fotograf

Sindi Budini

Design

Aldo Rrodostani

Përmbajtja:

- 4- DITA E PARË E KOPSHTIT
- 5- VITI SHKOLLOR 2020-2021
- 6- JAVA E ORIENTIMIT
- 7- TAKIM ME SHKRIMTARË
- 8- PAJISJA E KLASAVE V ME IPAD
- 9- MIRËNJOHJE NGA BASHKIA E DURRËSIT / OWLYPIA
- 10- KLUBET
- 11- TETORI, MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË
- 12- KLUBI I DEBATIT
- 13- TAKIMET ME PRINDËR 14- BINJAKËZIMI
- 14- MUAJI I HISTORISË DHE GJEOGRAFISË
- 15- KLUBI "SHPRESA"
- 16- "E PREMTJA E LEXIMIT"
- 17- ASEF JUNIOR DHE ASEF SENIOR 2021
- 18- 7-8 MARS
- 19- EKSPOZITA "DURRËSI YNË!"
- 20/21- OLIMPIADA
- 22- OLIMPIADA NOETIC
- 23- JAVA E MATEMATIKËS
- 24- PROVIMET E LIRIMIT DHE TË MATURËS SHTETËRORE
- 25- UNË DHE KOMPJUTERI
- 26- EKSPERIMENTE NË LËNDËT SHKENCORE
- 27- "COGITO 2021"
- 28- AKTIVITETET E KOPSHTIT
- 29 - MyON/ IXL
- 30- SHPËRNDARJA E CERTIFIKATAVE
- 31- EDUCATION TODAY
- 32- KUIZI EVROPIAN I PARASË
- 33- NJË HISTORI SUKSESI
- 34- PANAIRI SHKENCOR 2021
- 35- "RICIKLOJMË-RIPËRDORIM-REDUKTOJMË"
- 36- EKSELENTJA DEA MYSHKETA PRANOHE TË MIT
- 37- MBRËMJA E MATURËS 2021

KOPËSH
9-VJEÇARE
E MESME

Kontakte

Adresa: Lagja 14, Mbikalimi i Shkozetit Durrës - Shqipëri

Mobile: +355 69 74 99 292

Web: durresturgutozal.edu.al

E-mail: infodurres@turgutozal.edu.al

Facebook: [turgutozaldurresofficial](https://www.facebook.com/turgutozaldurresofficial)

Instagram: [turgutozal_collegedurres](https://www.instagram.com/turgutozal_collegedurres)

DITA E PARË E KOPSHTIT

Më 1 shtator 2023 nisi viti i ri akademik për kopshtin "Turgut Ozal". Një ditë kjo e mbushur me emocione, përqaftime dhe shpresë. Zërat e ëmbël të fëmijëve mbushën serish klasat, duke e bërë këtë ditë emocionuese, jo vetëm për fëmijët, por edhe për stafin e mësimdhënësve. Është dita kur ne nisim një rrugëtim të ri drejt rritjes dhe dijes, drejt aventurave dhe suksesit.

Me besimin se ne jemi një familje e madhe, do të punojmë së bashku me përkushtim për të dhënë më të mirën tonë në rritjen dhe edukimin e këtyre vogëlushëve të mrekullueshëm. Këtu është pikënisja e një rruge të gjatë edhe të bukur. Dita e parë e kopshtit, pa fjalë të çuditshme apo përsosmëri letrare, bëhet një histori emocionuese e ndryshimit dhe zhvillimit për këta vogëlushë që po përcaktojnë fillimin e një udhëtimi të ri.



VITI SHKOLLOR 2023-2024

Vera kaloi mes argëtimesh të ndryshme. Erdhi shtatori, muaji i fillimit të shkollës. Oborri dhe çdo mjedis tjetër i shkollës gumëzhin nga zërat e fëmijëve, të cilët mezi presin të ritakojnë shoqërinë e mëparshme apo dhe të krijojnë njohje të reja, sidomos ata që vijnë për herë të parë në këto ambiente. Sa emocion sjell kjo ditë...

Krenarë jemi të gjithë përballë kësaj panorame plot ngjyra dhe premtuese për një të ardhme të bukur dhe me sfida të reja



PROGRAMI I ORIENTIMIT

Nxënësit që regjistrohen për herë të parë në shkollën "Turgut Ozal", në çdo cikël mësimor, në ditët e para të shtatorit krijojnë një njohje paraprake më nga afër me shkollën nëpërmjet orëve orientuese. Qëllimi kryesor i tyre është fokusi në ndihmë të nxënësve të rinj përmes aktiviteteve të shumta: informuese, argëtuese, njohja me ambientet e shkollës, me planin akademik, sidomos me lëndët shkencore të zhvilluara në gjuhën angleze, me stafin si dhe me klimën e re shoqërore ku ata tashmë do të bëhen pjesë.



TAKIME ME PERSONALITETE TË FUSHAVE TË NDRYSHME

Në shkollën "Turgut Ozal" Durrës përherë ka qenë tradita e mikpritjes. Në kuadër të bashkëpunimit me vlerë edukative- kulturore, ndër vite kanë ardhur figura të njohura shqiptare e të huaja për të përcjellë mesazhin e tyre tek nxënësit tanë. Mund të themi me bindje të plotë që ndihemi krenarë për vlerësimin që na është bërë nga personalitete të fushave të ndryshme të kulturës, artit, shkencës, historisë e shumë të tjerë. Këto aktivitete kanë pasur në qendër jo vetëm personin e ftuar, por dhe vetë nxënësit të cilët kanë biseduar, intervistuar, dramatizuar dhe performuar pjesë të ndryshme që lidhen me mesazhin dhe qëllimin e vizitës. Duke shprehur që e ardhmja do të vazhdojë me të njëjtat hapa miqësorë, plot vlera e me komunikim të ndërsjelltë midis nxënësve dhe figurave të njohura prej të cilave ne mund të marrim më të mirën, sigurojmë që shkolla jonë kultivon tek të rinjtë ndjenjën e punës, kreativitetit, dashurinë për atdheun e artin duke sjellë shembuj konkretë për nxënësit. Në ambientet e shkollës sonë janë ftuar personalitete të tilla si:

1. Elda Kalaja – Head of Secretary General Cabinet-Sekretarja e përgjithshme e Ministres së Integritimit
2. Romario Shehu – përfaqësues i IDM Albania" Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim"
3. Genta Hoxha – përfaqësuese e IDM Albania" Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim"
4. Durim Caca – poet
5. Josif Dodja – shkrimtar
6. Shefik Myftiu – shkrimtar
7. Xhaferr Xhiani – historian
8. Ylber Merdani – shkrimtar
9. Flora Dervishi – shkrimtare
10. Hajredin Isufi – historian
11. Teuta Dhima – poete





KLUBET NË SHKOLLË

Kolegji "Turgut Ozal", krahas kujdesit që tregon për mbarëvajtjen e procesit mësimor, tregon kujdes edhe për angazhimin e nxënësve gjatë kohës së lirë në përfshirjen e tyre në klube të ndryshme. Fokusi kryesor i organizimit të tyre ka të bëjë me nxitjen e kreativitetit, përforcimin dhe zgjerimin e njohurive në shkencat natyrore, shoqërore, atyre kompjuterike, të gjuhëve të huaja, orientimin e karrierës, ndërgjegjësimin në aspektin human etj, duke krijuar një atmosferë pune të këndshme, çlodhëse dhe argëtuese njëkohësisht." E ardhmja u përket atyre që përgatiten për të sot", është motoja e klubit "Global Perspective", së cilës i bashkangjiten dhe motot e klubeve të tjera.

- Në ciklin fillor frekuentohen këto klube: klubi i pianos, i futboll-basketbollit, i volejbollit, i artit, i shahut- lojërave logjike, i shkencave, i gjermanishtes dhe i kërcimit.
- Në AMU frekuentohen këto klube: klubi i robotikës, i programimit dhe i multimedias.
- Në AML frekuentohen këto klube: klubi i karrierës, i debatit, i shkrimit akademik, i perspektivës globale, i librit dhe mendimit kritik, i artit dhe dizajnit, i multimedias, i shkencave, i dil kafesë dhe i sportit.



KLUBI I DEBATIT

Qëllimi i këtij klubi është forcimi i kulturës së diskutimit dhe debatit tek nxënësit tanë si dhe aftësimi i tyre në të folurit në publik. Komunikimi është çelësi që hap dyer të shumta në jetë. Debatit, si pjesë e komunikimit, i bërë në mënyrë konstruktive duke mbrojtur teza me argumente apo duke i rrëzuar ato në po të njëjtën mënyrë, nxit të nxënësit të menduarit ndryshe. Aktivitetet e këtij klubi zhvillohen sa në shkollë, sa dhe jashtë saj. Përmendim vizitat në universitetin "Bedër", në Muzeun Kombëtar të Përgjimeve "Shtëpia me gjethe" etj.



KLUBI “SHPRESA”

Ndarja e të mirave materiale me të tjerët, ndjeshmëria, humanizmi dhe edukimi me të tilla vlera ushqehen nga dëshira për të dhënë mbështetje dhe shpresë për njerëzit në nevojë. Kjo është nismë e nxënësve të shkollës sonë, të cilët nëpërmjet përfshirjes së tyre në klubin “ Shpresa”, bëjnë të mundur realizimin e tyre në mjedise të ndryshme familjare apo institucionale. Ndër aktivitetet e shumta të këtij klubi veçojmë:

1. Shpërndarjen e pakove me ushqime, me lodra për fëmijë apo me mjete mësimore për familjet në nevojë qytetit të Lushnjës, Shijakut, Kavajës, në fshatin Vadardhë, në pediatriinë e qytetit të Durrësit dhe në Shtëpinë e Fëmijës së po këtij qyteti. (Këto realizohen më së shumti në prag të festave të fundvitit dhe të 7-8 Marsit)

2. Mbledhjen dhe dhurimin e librave si pjesë e nismës “Dhuro një libër”, gjatë Tetorit, Muajit të Artit dhe të Letërsisë, por jo vetëm. Libra të shumtë iu dhuruan Bibliotekës së Fëmijëve në Durrës dhe shkollave: “ Shaqe Mazreku”, “ Marie Kaçulini”, “Vëllezërit Haredinaj”, “Eftali Koçi”, “Hajdar Dushi”, “Shkolla e Re”. Në Kavajë u dhuruan libra shkollave: “3 Dëshmorët”, “Fiqiri Kurti”, “Herbert”, ndërsa në Shijak shkollës “ Rilindja”.



WORLD SCHOLAR'S CUP

The World Scholar's Cup, është programi akademik ndërkombëtar, në të cilin marrin pjesë çdo vit rreth 50 000 studentë nga rreth 70 vende të botës, i cili realizohet tashmë edhe në Shqipëri, në kompleksin "Turgut Ozal" në Tiranë . Nxënësit konkurrojnë në fusha të ndryshme si: "Team Challenge", "Debate Champions", Team Bowl", "Writing Champions", "Challenge Subjects", "Team debate", "Team Writing", "School Top Scholars", dhe "Champion Scholars". Aktivitete të tilla e çojnë arsimin në një tjetër nivel, ndaj dhe ne në emër të arsimit, kontribuojmë për të ardhmen e nxënësve tanë.



ASEF

ASEF (Albanian Science and Engineering Fair), është konkurs ku nxënësit garojnë me punën, arritjet e tyre jo vetëm në lëndët shkencore, por edhe në lëndët shoqërore në dy periudha, përkatësisht në kategoritë; ASEF LITTLE SCIENTISTS, ASEF JUNIOR dhe ASEF SENIOR. Konkurrimi në këtë olimpiadë idesh është i hapur, duke përfshirë jo vetëm nxënës të shkollës "Turgut Ozal", por edhe nxënës të shkollave të tjera private dhe publike. Ky panair i arritjeve bën bashkë forcën krijuese dhe aftësinë për të prezantuar dijen në projekte konkrete dhe origjinale. Finalizimi i emocioneve të garës kurorëzohet me certifikata dhe medalje.



MEDALJE TË FITUARA

ASEF SOCIAL 2024

ASEF LITTLE SCIENTISTS

GOLD MEDAL 2

SILVER MEDAL 2

BRONZE MEDAL 9

ASEF JUNIOR

GOLD MEDAL 9

SILVER MEDAL 16

BRONZE MEDAL 25

ASEF SENIOR

GOLD MEDAL 23

SILVER MEDAL 28

BRONZE MEDAL 27

ASEF SCIENCE 2024

ASEF LITTLE SCIENTISTS

GOLD MEDAL 3

SILVER MEDAL 7

BRONZE MEDAL 5

ASEF JUNIOR

GOLD MEDAL 14

SILVER MEDAL 12

BRONZE MEDAL 18

ASEF SENIOR

GOLD MEDAL 14

SILVER MEDAL 22

BRONZE MEDAL 27



MUAJI I ARTIT DHE I LETËRSISË

Me trokitjen e Tetorit, "Muajit të Artit dhe Letërsisë", në shkollën tonë fillon një maratonë aktivitesh e konkursesh. Konkursët e fjalës artistike, kompozicionit, këngës, valleve me motive tradicionale dhe artit figurativ, janë nga veprimtaritë më të dashura për nxënësit. Prandaj kjo traditë do të vazhdojë e do të pasurohet ndër breza në shkollën tonë. Formimi i gjithanshëm i nxënësve është qendër e vëmendjes së stafit mësimor në kolegji. Gjithçka përfundon me finalen e madhe, e cila paraprihet nga konkursët reciproke të zhvilluara në secilën shkollë dhe një punë përgatitore dhe të përkushtuar, si prej nxënësve ashtu dhe mësuesve. Vlerësimi i nxënësve konkurrentë bëhet nga juri profesionale për secilën fushë. Konkursët e realizuara shpalosin talentin e nxënësve në fusha të ndryshme dhe dhurojnë emocione të papërshkrueshme si te nxënësit, ashtu edhe te juria.



EDUCATION TODAY

Një nga modelet më të mira të edukimit global organizuar për të 8-in vit radhazi në mjediset e shkollës fillore "Turgut Ozal" Tiranë. Kjo konferencë bashkon mësuesit, profesionistët e arsimit në zhvillimin e tyre profesional. Kjo mbështetje ofron platforma, përvoja në arsim sjellë në ligjërimet e personaliteteve të njohura kombëtare e ndërkombëtare, prezantime me postera, mundësi të mëdha njohjeje e rrjetëzimi, diskutime për pikëpamje dhe ide të reja duke kombinuar risitë e teknikave moderne në mësimdhënie.



MUAJT E LËNDËVE

Ndër aktivitetet e shumta që zhvillohen në shkollën tonë për formimin e gjithanshëm të nxënësve (shkencor, artistik, kulturor etj.) janë dhe projektet e realizuara në javët kushtuar: anglishtes, matematikës, artit dhe letërsisë, shkencave si dhe histori- gjeografisë.

Muaji i Historisë dhe Gjeografisë

Muaji i krenarisë dhe atdhedashurisë. Një muaj që na lidh me dy ngjarje të mëdha historike kombëtare, 28 dhe 29 Nëntorin. Gjatë këtij muaji shpalosen vlerat e trashëgimisë kulturore dhe historike të vendit tonë. Shkolla vishet kuqezi e simbolet e kombit tonë, punuar mjeshtërisht nga artdashësit tanë, shpalosen gjithandej. Nxënësit e çdo cikli hulumtojnë, zbulojnë dhe tregojnë rrënjët, degët dhe frytet që kanë gdhendur paraardhësit tanë. Këto shfaqen përmes prezantimeve të projekteve, punimeve në postera, veshjeve popullore, konkurseve me temë historike, realizimit të dokumentarëve etj.



Muaji i Shkencave

Java e shkencave, java e shumëpritur nga nxënësit të cilët kanë mundësi të eksplorojnë, mësojnë dhe argëtohen rreth shumë zbulimeve dhe aktiviteteve që java e shkencave ofron. Vlejnë të veçohen: konkurse, prezantime, punë kërkimore, eksperimente lëndore dhe bashkëpunime ndërlëndore interesante për sytë e spektatorëve nga mënyra se si japin e marrin ato nga njëra-tjetra.



Muaji i Gjuhëve të Huaja

Java e anglishtes, turqishtes dhe gjermanishtes, është një javë vërtet mbresëlënëse. Nxënësit zgjedhin një shtet dhe mbledhin materiale rreth simboleve të atij shteti, rreth gjuhës, rreth kulturës, rreth traditave, rreth vendeve të veçanta apo dhe historinë e tij. Klasa kthehet në një shtet miniaturë plot vlera, prezantime e projekte tepër të larmishme. Synimi i shkollës sonë është që t'i motivojë dhe inkurajojë nxënësit jo vetëm në përmirësimin e aftësive të tyre të shprehurit, por edhe t'u japë zë ideve të tyre në këto gjuhë.



Muaji i Matematikës

Kjo javë është e mbushur me aktivitete të shumëllojshme. Këto aktivitete kanë në fokusin e tyre shpalosjen e njohurive matematikore, logjike dhe bashkëpunimin në grup. Nxënësit përgatiten të zhvillojnë konkurse, teste, lojëra dhe prezantime. Ndër aktivitetet e shumta përmendim: IQ test, Kahoot, Sudokun si dhe konkursin e lojërave të inteligjencës.



FESTAT E 7-8 MARSIT

Data 7 Mars pa dyshim është ndër datat më të rëndësishme për kombin dhe shoqërinë e vendit tonë. Hapja e mësonjëtores së parë në Korçë, do t'i hapte rrugë hapjes së shkollave kudo në vend për të arsimuar dhe edukuar brezat e rinj dhe për të luftuar analfabetizmin që kishte kapluar vendin. Po ashtu dhe data 8 Mars zë vënd të rëndësishëm në historinë botërore të njerëzimit, por shumë më tepër të vendit të gruas në shoqëri. Në nderim të këtyre dy festave dhe figurave kryesore të tyre kopshti organizon koncerte shumë të bukura. Nënën e shohin si modeli i parë i gruas ideale, mbrojtëses së tyre më të madhe që bën çdo gjë perfekt për sytë e tyre të vegjël dhe që ju fal dashurinë më të pastër. Koncerti që fëmijët e grupeve të para, 3-4 vjeç dhe grupeve të dyta, 4-5 vjeç, sjellin para prindërve, gjyshërve të tyre i ngjan atyre të profesionistëve të vërtetë.



FESTAT E NËNTORIT

Të risës dhe të edukosh fëmijë duke u transmetuar vlerat morale dhe kombëtare është sa sfidë, po aq dhe privilegj. Rritja me ndjenjën për atdhe-dashurinë është ndër objektivat kryesore të çdo individi që i përket kombit shqiptar, por shumë më tepër e institucioneve arsimore.

Të mësuarit rreth simboleve kombëtare, këngëve patriotike dhe elementeve historike, i përfshinë fëmijët në një sërë procesesh artistike, krijuese, emocionuese dhe shkëmbimesh pa fund me njëri-tjetrin. Ngjyrat kuqezi mbizotërojnë kudo. Sytë dhe vëmendja e kureshtarëve të vegjël përqendrohen në performancat e shkëlqyera artistike të fëmijëve të grupeve parashkollore. Artistët tanë të vegjël, të veshur me veshje tradicionale popullore, kënduan këngë të folklorit, recituan vjersha patriotike dhe kërcyen valle popullore, të cilat çuan peshë të gjithë pjesëmarrësit në sallën e koncerteve.



OLIMPIADA “BRILLIANT MINDS”

Olimpiada e parë e parashkollorit “Brilliant Minds” u organizua për herë të parë në ambientet e Kolegjit “Turgut Ozaal”. Morën pjesë parashkollorët nga të gjitha kopshtet, përfshirë ato publike dhe jopublike, ku u testuan njohuritë e marra në tre lëndët kryesore; matematikë, gjuhë shqipe dhe dituri natyre. Olimpiada u zhvillua me datë 10 qershor 2023. Në këtë olimpiadë morën pjesë 36 fëmijë. Përveç testimit, fëmijët patën mundësinë të kalojnë një ditë ndryshe, nën tingujt e bukur të muzikës për fëmijë dhe lojërave argëtuese të organizuara nga stafi ynë. Qëllimi i kësaj olimpiade ishte jo vetëm testimi i njohurive, por edhe inkurajimi i fëmijëve në rrugën e bukur të dijes dhe arsimit. Rezultatet ishin mjaft të mira, dhe fëmijët ishin të gjithë të mrekullueshëm, dhanë maksimumin e tyre duke na dhuruar shumë emocione të bukura.

Të pranishëm ishin edhe prindërit, të cilët gjithashtu patën mundësinë të ishin pjesë e kësaj aventure në rrugëtimin e fëmijëve të tyre.

Fëmijët me rezultatet më të mira u vlerësuan me nga një çmim dhe një vlerë simbolike, si një mënyrë për të shpërblyer punën dhe përpjekjet e tyre gjatë periudhës së parashkollorit.



TAKIME ME PRINDËR

Në çdo shoqëri, arsimimi i një brezi të ri vendos themelet për një të ardhme të ndritur dhe të qëndrueshme. Në këtë drejtim, një partneritet i fortë dhe i vetëdijshëm mes shkollës dhe prindërve është kritik për suksesin e procesit arsimor.

Takimet me prindërit krijojnë një platformë për komunikim të drejtpërdrejtë dhe të hapur. Përvoja e ndarjes së informacionit në lidhje me përparimin në mësim, sjelljen dhe nevojat e fëmijës siguron që të dyja palët të jenë të përfshira në procesin e arsimit. Ky komunikim i hapur shpesh rezulton në një bashkëpunim më të mirë mes shkollës dhe familjes. Identifikimi i sfidave në kohë të hershme lejon shkollën dhe prindërit të bashkëpunojnë për zgjidhjen e tyre dhe për të siguruar një mjedis mësimor të përshtatshëm. Gjithashtu, takimet me prindërit lejojnë mësuesit të njohin më mirë nevojat individuale të secilit nxënës. Kjo njohje është themelore për të përshtatur mësimin në mënyrë efektive dhe për të ndihmuar fëmijën të zhvillohet në mënyrë optimale. Përvoja e përbashkët dhe bashkëpunimi efektiv ndikojnë drejtpërdrejt në arritjen e synimeve arsimore dhe në zhvillimin e fëmijëve.



MIRËNJOHJE NGA BASHKIA E DURRËSIT

Bashkia e Durrësit në një ceremoni të veçantë, të organizuar në Pallatin e Kulturës, vlerësoi nxënësit ekselentë me rezultate të shkëlqyera ndër vite si dhe fituesit në fazat e treta të Olimpiadave Kombëtare dhe realizoi shpërndarjen e Certifikatave të Mirënjohjes: "Në shenjë mirënjohje për punën e palodhur dhe përgatitjen sistematike, rezultatet e larta në mësimet si dhe për arritjet e shkëlqyera në olimpiadat kombëtare". Këto certifikata u shoqëruan me shpërblime monetare në shenjë motivimi për ta. Nga shkolla jonë janë vlerësuar 6 nxënës me Medalje Ari, përkatësisht: Sabrina Alushi, Dario Shandro, Ilva Dushi, Ema Kola, Engjëll Abazaj dhe Enkel Pengu, 2 nxënës ekselentë të maturës shtetërore: Laura Doraci, Lorenca Dardha dhe 2 nxënës fitues olimpiadash: Fabian Menekshi vendi II në Olimpiadën e Kompjuterit dhe Klejvisa Garuja vendi III në Olimpiadën e Letërsisë. Këta nxënës do të ndjekin ëndrrën e tyre drejt profesionit të dëshiruar dhe në të njëjtën kohë shërbejnë si model frymëzimi për nxënësit e tjerë për t'u treguar se munda, përpjekjet dhe puna e vazhduar vlerësohet dhe shpërblehet.



JEMI PJESË E MEDALISTËT



ILVA DUSHI



ENKEL PENGU



KLEA KOLA



LOARD BEJKO



LAURA KERTALLI



LAURA DORACI

SUKSESIT E ARTË



ENGJËLL ABAZAJ



DARIO SHANDRO



KLEJVISA GARUJA



EMA KOLA



LORENCA DARDHA



SABRINA ALUSHI

EKSPOZITA DHE AKTIVITETE KULTURORE

Kolegji "Turgut Ozal" Durrës ka krijuar një traditë të bukur disavjeçare në organizimin e ekspozitave dhe aktiviteteve të ndryshme me vlerë kulturore-edukative, në bashkëpunim me Bashkitë e Shijakut, Kavajës dhe Lushnjës. Ekspozita "Shqipëria në tela", organizuar në kuadër të festave të nëntorit, në qytetin e Kavajës, kishte si lajtmotiv të saj Shqipërinë ndër vite. Pjesa më e madhe e këtyre pikturave përcillnin vlerat e trashëguara historike dhe kulturore. Në gjithçka të realizuar nga nxënësit vlen të përmendet talenti dhe serioziteti i tyre si një dëshirë e brendshme për të ruajtur vlerat historike të vendit tonë. Aktivitete të tjera janë zhvilluar me rastin e festave të 8 Marsit në Shijak, Kavajë, Lushnjë dhe Durrës, të cilat ndërthurën mjaft bukur fjalën, këngën, kërcimin e interpretimin. Të gjitha këto elemente të përpunuara e interpretuar nga vetë nxënësit janë duartrokitur nga qindra të ftuar dhe nxënës të shkollave të tjera, të cilët përshëndetën dhe përgëzuan nxënësit tanë për nismën e marrë.



PROVIMET PROVË TË PKAB DHE MATURËS SHTETËRORE

Kolegji "Turgut Ozal" Durrës ka krijuar një traditë të bukur disavjeçare në organizimin e ekspozitave dhe aktiviteteve të ndryshme me vlerë kulturore -edukative, në bashkëpunim me Bashkitë e Shijakut, Kavajës dhe Lushnjës. Ekspozita "Shqipëria në telajo", organizuar në kuadër të festave të nëntorit, në qytetin e Kavajës, kishte si lajtmotiv të saj Shqipërinë ndër vite. Pjesa më e madhe e këtyre pikturave përcillnin vlerat e trashëguara historike dhe kulturore. Në gjithçka të realizuar nga nxënësit vlen të përmendet talenti dhe serioziteti i tyre si një dëshirë e brendshme për të ruajtur vlerat historike të vendit tonë. Aktivitete të tjera janë zhvilluar me rastin e festave të 8 Marsit në Shijak, Kavajë, Lushnjë dhe Durrës, të cilat ndërthurën mjaft bukur fjalën, këngën, kërcimin e interpretimin. Të gjitha këto elemente të përpunuara e interpretuar nga vetë nxënësit janë duartrokatur nga qindra të ftuar dhe nxënës të shkollave të tjera, të cilët përshëndetën dhe përgëzuan nxënësit tanë për nismën e marrë.



BASHKËPUNIME ME QKF

Ndër vite shkolla "Turgut Ozal" Durrës ka bashkëpunuar me institucione të ndryshme të qytetit në kuadër të zhvillimit kulturor e arsimor. Një vëmendje të veçantë ka marrë dhe ndërveprimi ynë i përbashkët me Qendrën Kulturale të Fëmijëve Durrës. Si organizatore e shumë aktiviteteve kulturore, artistike, sportive e shkencore QKF Durrës përherë ka qenë pjesë e zhvillimit edukativ të shkollës sonë. Jo pak herë nxënësit tanë kanë marrë pjesë në konkurse artistike kushtuar festave të ndryshme si: 28-29 Nëntori, 7-8 Marsi e shumë të tjera. Ata kanë konkurruar me piktura, këngë, interpretim dhe ese, ku dhe janë vlerësuar me çmime të ndryshme. Qëllimi i këtyre konkurseve është të nxisë kreativitetin tek fëmijët, gjë e cila bashkon synimet tona të përbashkëta si institucion arsimor dhe edukativ. Nuk duhet lënë pa përmendur edhe olimpiada e matematikës, e cila merr rëndësi të veçantë për ne.

Duke u përgatitur në mënyrë të vazhdueshme, nxënësit tanë janë tashmë pjesë e pandashme e këtyre garave dhe përherë triumfues me rezultate të larta e çmime të merituar, jo vetëm brenda qarkut të Durrësit, por edhe në nivel ballkanik. Risi e viteve të fundit ka qenë edhe konkursi shkencor "Unë dhe kompjuteri", ku natyrisht jemi përfaqësuar me nxënësit tanë më të mirë në prirjet kompjuterike dhe jemi ndier krenarë për arritjet e tyre të shkëlqyera në çdo garim.

Pjesëmarrja jonë në këto aktivitete vjen jo vetëm si dëshirë e jona, por dhe si një bashkëpunim i ndërsjelltë me këtë institucion, i cili shpeshherë ka organizuar shumë prej këtyre aktiviteteve në mjediset e shkollës sonë. Arsimi duhet të jetë gjithpërfshirës dhe është detyra jonë të zhvillojmë imagjinatën e fëmijëve, t'i nxisim ata dhe të bëjmë më të mirën e mundshme për një të ardhme të sigurt për brezat e ardhshëm.



EPIDAMNUS

Shkolla "Turgut Ozal", sikurse shumë shkolla të tjera të Durrësit është e përfshirë në maratonën artistike "Epidamnus", ku të rinjtë dëshmojnë se janë energjia, forca, e sotmja dhe e ardhnja. Përveç atmosferës së mrekullueshme artistike që sjellin, talentit të përgëzueshëm që shfaqin, ndihen pa dyshim edhe ethe e konkurrimit ndërmjet tyre. Nxënësit paraqiten me numra të ndryshëm artistikë në zhanre të ndryshme si: këngë, valle popullore, krijimtari-interpretim, etyde, aerobi, reportazhe etj, të cilat mundësojnë edhe njohje më të mira me njëri - tjetrin dhe pse jo krijojnë miqësi duke performuar së bashku. Ndër momentet më të veçanta ishte dhe ndarja e çmimeve të këtij rugëtimi me të gjitha ngjyrat e këtij festivali rinor, ku nxënësit tanë edhe këtë here, si çdo here tjetër fituan plot të tilla.



OLIMPIADA “COGITO”



Kjo olimpiadë zhvillohet midis nxënësve që janë pjesë e kolegjeve. Nxënësit pjesëmarrës konkurrojnë në lëndët shkencore si: matematikë, fizikë, kimi, biologji, informatikë. Kjo olimpiadë zhvillohet në gjuhën angleze. Olimpiada “Cogito” është një nismë sfiduese për nxënësit duke i ndihmuar e përgatitur ata për olimpiada të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Prej 13 vitesh radhazi nxënësit tanë testojnë njohuritë e tyre në lëndët shkencore. Në këtë provim marrin pjesë nxënësit e ciklit 9-vjeçar nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të. Përzgjedhja e fituesve në të gjitha kategoritë bëhet sipas provimit përzgjedhës në fillim të vitit shkollor. Mësuesit mentorë punojnë me nxënësit e përzgjedhur në lëndët e sipërpërmedura.



MYON

MyON, është biblioteka digjitale e personalizuar e përshtatshme për nivelin e çdo nxënësi nga klasa e tretë deri në klasën e nëntë. MyON është platformë që u jep studentëve akses në më shumë se 6000 libra digjitalë në gjuhën angleze. Titujt përputhen në mënyrë dinamike me interesat e secilit student, shkallën dhe nivelin e leximit.

IXL

Shkolla është një institucion arsimor-edukativ që të përgatit për jetën, dhe si e tillë, ajo është në sfidë të vazhdueshme për t'iu përshtatur të rejave më të fundit të kohës. IXL përdoret nga mbi 7 milionë nxënës në më shumë se 191 vende dhe ka fituar një sërë çmimesh nga më të njohurat në botë në fushën e edukimit. IXL jo vetëm që ofron një gamë mjaft të gjerë ushtrimesh dhe pyetjesh online, por e veçanta e kësaj platforme është se i siguron mësuesit të klasës një statistikë të detajuar, duke ndjekur ecurinë e grupit në tërësi dhe performancën e secilit nxënësi në veçanti.



NJË HISTORI SUKSES

MBRËMJA E MATURËS

Ceremonia e diplomimit të maturantëve është një ndër veprimtaritë më të veçanta e më mbresëlënëse që organizohen në kolegjin "Turgut Ozal" Durrës. "Kjo ditë shënon kurorëzimin e një rrugëtimi të gjatë e të bukur që mbart në vetvete plot sfida, arritje, suksese e përjetime të papërsëritshme e unike për secilin maturant. Kjo festë shënon thuajse finishin e një mbarimi cikli shkollor dhe fillimin e startimit të ri studentor. Ne të gjithë: prindër, mësues, drejtorja e shkollës, ndihemi krenarë për atë çfarë ju jeni sot dhe atë çfarë do të bëheni nesër." - kështu do të shprehej ndër të tjera, në fjalimin përshëndetës për maturantët drejtoresha e shkollës, zonja Frida Merdani. Në këtë mbrëmje nuk munguan falenderimet e shumta në adresë të prindërve, mësuesve, njëritjetrit, nuk munguan as përqaftimet e lotët e derdhur sa nga gëzimi, sa nga trishtimi dhe nostalgjia e kësaj ndarjeje të bukur...

Duke ju uruar suksese, dëshirojmë në të njëjtën kohë që secili prej tyre të vazhdojë më tej rrugëtimin e jetës duke përfaqësuar në formën më të mirë të mundshme veten, familjen, shkollën dhe gjithë shoqërinë.



MINIMATURA

Festa që i jep kuptim mbylljes së ciklit 9-vjeçar, pa dyshim që është minimatura, festë për të cilën drejtoria e shkollës, mësuesit dhe vetë nxënësit kujdesen që të dalë sa më bukur në mënyrë që të përjetësohet në memorien e secilit prej tyre. Me mesazhe dhe numra të ndryshëm artistikë, nxënësit mes emocioneve kujtojnë momentet më të bukura shkollore dhe përshëndesin mësuesit, prindërit dhe të gjithë të ftuarit. Duke festuar sukseset e arritura, por dhe duke premtuar përkushtim në rrugën e gjatë të dijes, ata mbyllin një cikël mjaft të rëndësishëm të arsimimit dhe edukimit.



SHKOLLA VERORE

Shkolla verore, e cila organizohet pas finalizimit të vitit akademik në ambientet e kolegjit "Turgut Ozal" dhe jo vetëm, nën kujdesin e stafit tonë tashmë është bërë një traditë që shërben si një kohë e veçantë e frymëzimit dhe argëtimit për nxënësit tanë. Gjatë kësaj periudhe, ata marrin pjesë në një gamë të gjerë aktivitetesh, duke filluar nga ato sportive dhe artizanale, deri tek ekskursionet interesante. Nëpërmjet bashkëpunimit në lojëra dhe projekte grupore, nxënësit mësojnë të komunikojnë dhe të ndajnë ide, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për rritjen e aftësive sociale. Shkolla verore nxit kreativitetin dhe shpirtin aventurier të nxënësve, duke i frymëzuar ata të eksplorojnë dhe zhvillojnë potencialet e tyre në mënyrë argëtuese dhe arsimuese.



KOPSHTI VEROR

Vera e fëmijëve këtë vit kishte vetëm një titull "Lojëra dhe argëtim pa fund në kopshtin "Turgut Ozal". Viti akademik 2022-2023 u mbyll me sukses. Grupet parashkollore hodhën kapelen e parë të diplomimit, ndërsa fëmijët e grupeve të para dhe të dyta tregonin me krenari të prindërit dhe gjyshërit e tyre punimet artistike që mbanin në dosjet e tyre. Mbyllja e vitit akademik ia la vendin një nisme të re të ndërmarrë nga kopshti ynë. Për herë të parë u organizua kopshti veror, me qëllimin që t'u ofronte fëmijëve argëtim, lojëra dhe ndërveprim ndërmjet tyre. Angazhimi i stafit u përqendrua në aktivitetet e ndryshme artistike-krijuese, lojëra, kraft, aktivitete fizike, si dhe lojëra në pishina. Përsëritja e njohurive të mara, përvetësimi i njohurive të reja janë kurdoherë interesante për fëmijët kur zhvillohen në formën e lojës. Temperaturat verore favorizojnë daljet në oborr, vëzhgimin dhe eksplorimin e mjediseve të jashtme duke përbushur nevojën e fëmijëve për të vrapuar, lëvizur dhe për t'u ndier të lirë. Fëmijët realizuan ekskursione edukative dhe argëtuese në një sërë destinacionesh si:

-Sektori Rinia, ku realizuan piknik nën hijen e pishave. Ata prekën nga afër natyrën me gjithë larmishmërinë e ngjyrave të saj. Pemët, me gjithë hijeshinë e tyre u bënë tabloja ku fëmijët pikturuan atë ç'ka shihnin, sipas mënyrës së tyre.

-Bujtina "Ajazi", mbetet një nga destinacionet që fëmijët patën mbresa të veçanta. Thënë kjo pasi atje panë nga afër kafshët e fermës dhe se si fermeri kujdesej për to. Fëshfërima e gjethëve dhe tingujt e tjerë të natyrës ishin qetesuesit idealë për fëmijët që kishin ecur, luajtur pa reshtur që në momentin e mbërritjes.

-"Latitude", vendi ku fëmijët argëtohen dhe janë në aktivitet fizik pothuajse gjatë gjithë qëndrimit. Ambjentet shumëngjyrëshe, si dhe arenat e ndryshme të lojërave, bënë që fëmijët të nisnin menjëherë lojën e tyre. Ngjitje në mure, hedhje nga lartësia, rënie e lirë në rrjetën e lartësisë, rrëshqitjet etj, ishin vetëm disa nga aktivitetet që fëmijët realizuan.

-Kavalishenca, një eksperiencë fantastike për fëmijët. Këndi i preferuar i fëmijëve ishte pa dyshim ai i rërës, ku ata eksploronin, kërkonin, manipulonin rërën me duar si dhe krijonin pa fund me të.

Teksa fëmijët kënaqen, argëtohen dhe mësojnë, stafi i kopshtit nis përgatitjet për vitin e ri akademik, për të ofruar një shërbim arsimor sa më cilësor.



SHKOLLA VERORE NE ANGLI

Shkolla verore në Angli është një nga përvojat më mbresëlënëse për nxënësit e shkollës sonë. Ata kalojnë disa ditë të mrekullueshme me një program të pasur, ku gërshetohen mësimi me elemente kulturore dhe sociale. Nxënësit vizitojnë vende të ndryshme, njihen nga afër me kulturën e tyre, eksplorojnë muze historike dhe shkencore. Mësimi intensiv i gjuhës angleze me nxënës nga e gjithë bota e bën këtë udhëtim edhe më sfidues për nxënësit tanë. Një formë mjaft e mirë kjo, për t' i përgatitur ata për studime të ardhshme në UK.



VANAF

Vlerësimi kombëtar i arritjeve të nxënësve të klasës së 5-të të arsimit të detyruar synon të vlerësojë njohuritë dhe kompetencat bazë, të fituara nga nxënësit në ciklin fillor, në lëndët: gjuhë shqipe, matematikë dhe dituri natyre. Para zhvillimit final të testit nxënësit kanë mundësi të praktikojnë njohuritë e tyre nën mbikqyrjen e mësuesve të lëndëve.



AKTIVITETET SPORTIVE NË SHKOLLË

Aktivitetet sportive në shkollë janë një pjesë e rëndësishme e zhvillimit të fëmijëve dhe të rinjve. Kjo jo vetëm që kontribuon në përmirësimin e shëndetit fizik, por gjithashtu promovon disiplinën, bashkëpunimin dhe aftësitë sociale. Në shkollën tonë zhvillohen aktivitete të ndryshme sportive, duke ofruar një gamë të gjerë sportesh si: futboll, basketbolli, volejbolli, hendbolli, pingpongu etj. Këto aktivitete jo vetëm që ndihmojnë në zhvillimin e aftësive motorike dhe koordinatave, por gjithashtu ndihmojnë në menaxhimin e stresit dhe promovimin e mirëqenies emocionale. Përveç kësaj, aktivitetet sportive në shkollë kanë një ndikim pozitiv në disiplinën shkollore dhe motivon nxënësit të jenë më të përkushtuar në mësimet. Ata zhvillojnë aftësitë e tyre dhe mësojnë rëndësinë e ekipit dhe bashkëpunimit. Këto aktivitete kanë një rol kyç në formimin e një gjenerate të shëndetshme, aktive dhe të përgatitur për sfidat e jetës. Është e rëndësishme që ne si shkollë të vazhdojmë të investojmë në këto programe dhe të inkurajojmë pjesëmarrjen e gjerë të nxënësve në aktivitete sportive.





KESHILLIMI I KARRIERËS

Zyra e këshillimit dhe orientimit në shkollë ofron udhëheqje dhe angazhon të gjithë të interesuarit në ofrimin e programeve dhe shërbimeve për të ndihmuar nxënësit të arrijnë suksese në shkollë, konkurset kombëtare dhe ndërkombëtare. Konkurse si: WSC, OLIMPIA, ASEF, ART DHE LETERSI, FESTIVALI RINOR "EPIDAMNUS" etj.

Aktivitete të shumta të zhvilluara, përfshirja në seminare informuese për provimet MSH, seminare mbi përgatitjen e dokumentacionit për aplikime në universitete, aktivizimi në klube që ndihmojnë për njohjen e nxënësve me profesione dhe zhvillimin e aftësive që lidhen me ushtrimin e tyre, aftësi e qëndrime të tjera si iniciativa, aftësitë sipërmarrëse dhe bashkëpunimi.

FESTA E ABETARES

Ndodh vetëm një herë në jetë, të fal emocione të papërshkrueshme dhe të bën të fluturosh në majat më të larta! Është ajo, e bukura "Festa e Abetares", e cila kurorëzon 36 shkronjat e alfabetit tonë të çmuar. Çdo zë i ëmbël fëmënor reciton ,këndon e aktron vargjet më të bukura në skenën e festës dhe emocionet e tyre depërtojnë thellë në zemrat tona. Suksese çdo vogëlushi në këtë festë! Qoftë sa më e ndritur rruga e tyre drejt dijes!



SENATI I SHKOLLËS

Zgjedhjet garuese për presidentin e qeverisë së nxënësve në shkollë për vitin shkollor 2023-2024, sollën platformat e katër kandidatëve: Irjan Kuliçi, Ester Gjakës, Adela Hoxhës dhe Samanta Sulës. Gjatë prezantimeve të tyre në çdo klasë kandidatët premtonin ndër të tjera se do të ishin aktivë në proceset e ndryshimeve në shkollë në lidhje me ndikimin që do të kishin në realizimin e aktiviteteve të ndryshme, rritjen e iniciativës, frymën e bashkëpunimit, etj. Ishte një garë me shumë emocione në të cilën triumfoi nëpërmjet votës maturanti Irjan Kuliçi.



FIRST LEGO LEAGUE

First Lego League (FLL) është një program konkurrues ndërkombëtar i zhvilluar për të frymëzuar interesin e fëmijëve në shkencë dhe teknologji. Pjesëmarrësit, të cilët zakonisht janë të moshave nga 9 deri në 16 vjeç, përfshihen në sfida të ndërtuara rreth temave të ndryshme dhe të përditshme që ndërthuren me shkencën dhe teknologjinë.

Programi përbëhet nga tri komponentë kryesorë:

- Projekti i Kërkimit Shkencor: Ekipet zgjedhin dhe zgjidhin një problem të vërtetë shkencor ose shoqëror.
- Sfida e Robotikës: Ekipet ndërtojnë dhe programojnë një robot LEGO Mindstorms për të kryer një seri detyrash dhe sfidash të caktuara në një fushë të lojës.
- Vlerësimi i Vlerave të Njeriut: Ky komponent vlerëson aftësinë e ekipit për të punuar së bashku dhe për të treguar respekt, ndershmëri dhe të tjerë vlera themelore të FLL.

First Lego League inkurajon pjesëmarrjen, punën në ekip, dhe të mësuarit praktik. Është një mënyrë argëtuese dhe sfiduese për të nxjerrë në pah talentet e fëmijëve në inxhinieri, shkencë, teknologji dhe matematikë (STEM).

Ekipet përbëhen nga nxënës të moshave të ndryshme, të udhëhequr nga trajnerë ose mentorë. Ata marrin pjesë në sfida të ndryshme që kombinojnë ndërtimin e robotëve LEGO me zgjidhjen e problemeve të ndryshme të bazuar në tema aktuale.

Evenimentet dhe garat lokale të FLL në Shqipëri ofrojnë një platformë për të rinjtë për të demonstruar aftësitë e tyre në robotikë dhe për të zhvilluar aftësi të rëndësishme si puna në ekip, kreativiteti dhe zgjidhja e problemeve. Përmes këtyre aktiviteteve, FLL në Shqipëri synon të frymëzojë brezin e ardhshëm të inxhinierëve, shkencëtarëve dhe liderëve teknologjikë. Nxënësit e shkollës "Turgut Ozal" prej disa vitesh ndjekin këtë program të udhëhequr nga mësuesit e informatikës.




AFTERSCHOOL

Në kolegjin tonë ka vite që zhvillohet programi afterschool. Ky program cilësohet mjaft i dobishëm dhe efikas në stimulimin dhe lehtësimin e punës së nxënësve. Bazuar në kushtet bashkëkohore që disponon kolegji ynë e ka shfrytëzuar më së miri këtë program në komunikim me mësuesit dhe prindërit në interesin e përbashkët kundrejt nxënësve dhe krijimit të mëtejshëm të një atmosfere bashkëpunuese shkollë-familje.



APERTURE

Programi Aperture është një sistem online, i cili bazohet në pyetje, të cilat matin aftësitë social-emocionale të nxënësve. Para realizimit të vlerësimit duke u bazuar në programin Aperture, në klasë dhe në shkollë zhvillohen aktivitete edukative nëpërmjet të cilave synohet mbështetja e aftësive social-emocionale me bazë kompetencat e edukimit social-emocional.



“REGJIMI KOMUNIST NË SHQIPËRI”

LAURA KËRTALLI

I sjellë në dritë nga autorja, ky libër është si një pikë uji në detin e madh të vuajtjeve të veprimtarëve politikë në regjimin e asaj kohe. Libri “Regjimi komunist në Shqipëri” i maturantes ,Laura Kërtalli, është një pasqyrim objektiv i bazuar në dokumente e fakte historike, si dhe i mbështetur në rrëfimet e gjyshit të saj. Për më shumë se një libër, ai është një aktakuzë e hapur për një kohë të egër ku gjykimi i fjalës së lirë ndalohej dhe vritej nga politika e egër e regjimit. Në promovimin e këtij libri mësues, nxënës dhe të ftuar të tjerë shprehën mendimet dhe vlerësimet e tyre për këtë vepër.

Ky është një fillim i mbarë i Laurës dhe urojmë që të pasohet dhe nga libra të tjerë.



ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE

Një udhëtim i ri ,por dhe shumë i rëndësishëm nis çdo vit për mësuesit e kolegjit "Turgut Ozal". Pjesë e zhvillimit profesional të mësuesit janë edhe trajnimet e organizuara për rritjen e cilësisë dhe përqafimin e metodave më bashkëkohore. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional mban mësuesit të angazhuar në hulumtimet e reja mbi mënyrën se si nxënësit mësojnë, përditësimin me programet dhe mjetet e reja të teknologjisë etj.



KONKURSI I PARASË







KONKURSI “MENDIMI IM, FORCA IME ”

“Mendimi im , forca ime” ishte konkursi që solli forcën poetike krijuese nëpërmjet penës së nxënësve të gjimnazeve të shkollave të ndryshme. Shkolla jonë në këtë konkurs u përfaqësua nga maturantja Silva Rusi, poezia e së cilës ishte nga më të vlerësuarat dhe më të klikuarat në rrjetet sociale. Nxënësja e talentuar shpalosi vlerat e gjuhës shqipe, forcën dhe butësinë e saj me vargje të mrekullueshme kushtuar as “...Shqip foli Muji kur u takua me Zanat / E po shqip përralla nga gjyshja tregohet...” duke dashur që këtë gjuhë “hyjnore” siç e cilësonte Fishta ta përcjellim brez pas brezi.



